

Shoqëria Konkensionare NOA Inspect sh.p.k

**Raporti i Audituesit të pavarur dhe
Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

PËRMBAJTJA	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	i
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E PERFORMANCËS DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIME SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE	5-14

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

**Drejtuar: Ortakut dhe Drejtimit të shoqërisë konçesionare
"NOA INSPECT" sh.p.k.**

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2021.

Opinion

Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare të shoqërisë konçesionare "NOA INSPECT" sh.p.k., të cilat përfshijnë Pasqyrën e Pozicionit Financiar më datë 31 Dhjetor 2021, Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve dhe të Ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e Flukseve të Parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, Pasqyrën e Ndryshimeve në Kapital si dhe shënimet shpjeguese, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë,

Pasqyrat Financiare bashkëlidhur paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë në datën 31 Dhjetor 2021 dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë në pajtim me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), të përmirësuar.

Baza për opinionin


Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standarteve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga shoqëria "NOA Inspect" sh.p.k., në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit Ndërkombëtar për Standardet e Etikës (kodi i IESBA) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e Etikës. Ne besojmë se evidenca që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishme në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje, ne nuk japim opinion të veçantë.

Përgjegjësia e Drejtimit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), të përmirësuar dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.



Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA- ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to, në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.



Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

Nga çështjet e komunikuara personave të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe për pasojë edhe çështje kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditimit përveç nëse në rastin kur ligji ose rregullat e ndalojnë bërjen publike të çështjes ose kur, në raste jashtëzakonisht të rralla, ne vendosim që çështja të mos komunikohet në raportin tonë për arsye se pasojat negative nga një komunikim i tillë pritet në mënyrë të arsyeshme të tejkalojnë përfitimet në favor të interesit publik.

Auditues Ligjor
Brunilda Stefa



Tiranë, më 14.04.2022

Shoqëria Konkensionare NOA Inspect sh.p.k
Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2021
(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit	4	14,913,125	16,585,840
Të tjera të arkëtueshme	5	7,188,176	5,041,592
Mjete monetare	6	31,563,685	18,273,980
Aktive afatshkurtra totale		53,664,986	39,901,412
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata jomateriale – e drejtë konkensionare	7	65,468,386	65,582,480
Aktive afatgjata totale		65,468,386	65,582,480
AKTIVE TOTALE		119,133,372	105,483,892
DETYRIME DHE KAPITALI			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme	8	8,919,264	7,979,095
Hua afatshkurtër nga palët e lidhura	9	109,297,709	109,297,709
Detyrime të tjera	10	9,481,694	845,769
Tatim fitimi i pagueshëm	11	919,437	-
Detyrime afatshkurtra totale		128,618,104	118,122,573
DETYRIME TOTALE		128,618,104	118,122,573
Kapitali			
Kapital i paguar	12	1,000,000	1,000,000
Humbje e akumuluar		(10,484,732)	(13,638,681)
Totali i kapitalit		(9,484,732)	(12,638,681)
DETYRIME DHE KAPITALI TOTAL		119,133,372	105,483,892

Pasqyra e konsoliduar pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-14 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë konkensionare NOA Inspect sh.p.k më 8 prill 2022 dhe firmosur për llogari të tyre nga:

Hazbi Metaj
Administrator



PricewaterhouseCoopers Consulting Sh.p.k.
Hartuesi

Shoqëria Konkensionare NOA Inspect sh.p.k

Pasqyra e performancës dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Të ardhurat nga shërbimet	13	96,210,200	64,365,500
Shpenzime operative			
Shpenzime administrative	14	(44,382,633)	(18,154,984)
Shpenzime të personelit	15	(31,448,583)	(33,713,267)
Shpenzime amortizimi	7	(14,395,229)	(14,633,450)
Fitimi operativ		5,983,755	(2,136,201)
Të ardhura/(Shpenzime) nga interesi		(1,880,328)	127
Të ardhura/shpenzime nga kursi i këmbimit		9,958	2,415,016
Shpenzime financiare neto	16	(1,870,370)	2,415,143
Fitimi para tatimit		4,113,385	278,942
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	17	(959,436)	-
Fitimi i vitit neto		3,153,949	278,942
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		3,153,949	278,942

Pasqyra e konsoliduar e performancës dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-14 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Shoqëria Konkensionare NOA Inspect sh.p.k
 Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
 (shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	<u>Kapital i paguar</u>	<u>Fitime/Humbje të mbartura</u>	<u>Total</u>
Pozicioni financiar më 1 janar 2020	1,000,000	(13,917,621)	(12,917,621)
Fitimi vitit	-	278,942	278,942
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	1,000,000	(13,638,681)	(12,638,681)
Pozicioni financiar më 1 janar 2021	1,000,000	(13,638,681)	(12,638,681)
Fitimi i vitit	-	3,153,949	3,153,949
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021	1,000,000	(10,484,732)	(9,484,732)

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapitalin neto duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-14 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Shoqëria Konkensionare NOA Inspect sh.p.k
Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021
(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti operativ			
Fitimi i vitit para tatimit		4,113,385	278,942
Rregullimet për:			
Shpenzime amortizimi	7	14,395,229	14,633,450
		18,508,614	14,912,392
 Rënie/(Rritje) të arkëtueshme tregtare		1,672,715	(5,315,999)
Rritje në te arkëtueshme të tjera		(2,146,584)	-
Rritje/ (Rënie) në llogari të pagueshme		940,170	8,467,774
Llogari të pagueshme të tjera		8,635,925	-
		27,610,840	18,064,167
 Tatim fitim i paguar		(40,000)	-
Mjete monetare neto arkëtuar/(përdorur) në aktivitetin operativ		27,570,840	18,064,167
Fluksi i mjeteve monetare përdorur në aktivitetin e investimit			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		(14,281,135)	(8,659,458)
Mjete monetare neto përdorur në aktivitetin e investimit		(14,281,135)	(8,659,458)
 Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti i financimit			
Dividend i paguar		-	-
Mjete monetare neto nga aktiviteti i financimit		-	-
 Rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalente me to		13,289,705	9,404,709
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të periudhës		18,273,980	8,869,271
Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor		31,563,685	18,273,980

Pasqyra e konsoliduar e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-14 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Shoqëria Konkensionare NOA Inspect sh.p.k
Shënime Shpjeguese mbi Pasqyrat Financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
(shumat në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Konkensionare NOA Inspect Shpk ("Shoqëria" ose "NOA Inspect") u themelua në 18 korrik 2019 si Person Juridik me NIPT L91918012B.

Me datë 28 gusht 2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë si Autoriteti Kontraktues, NOA Control Shpk si konkensionari dhe NOA Inspect si Shoqëri Konkensionare kanë lidhur një kontratë konkensionare.

Shoqëria Konkensionare ka si objekt të veprimtarisë së saj hartimin e Projektit përfundimtar, projektimin, vënien në punë të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumentave matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumentave shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, ofrimin e shërbimit të kërkuar dhe transferimin e pajisjeve të Sistemit Operativ të Autoriteti Kontraktues pas përfundimit të afatit të konkencionit.

Mbi bazën e kontratës konkensionare, investimet që duhet të kryhen nga konkensionari janë në vlerën totale 70,000,000 Lekë. Konkensionari, para nënshkrimit të kontratës ka siguruar në një shoqëri sigurimi për llogari të Autoritetit Kontraktues, një shumë prej 7,000,000 Lekë që përbën 10% të vlerës totale të investimit për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës.

Ky konkension jepet për një periudhë 20 vjetësh nga data efektive. Data efektive është 31 mars 2020.

Tarifat e shërbimit për çdo verifikim të çdo aparati/instrumenti matës të shpërndarjes së karburantit ose gazit të lëngshëm do jenë sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë dhe Ministrisë së Financave nr 2, datë 08.02.2013. Në asnjë rast nuk mund të jenë më të ulta se sa në udhëzim.

Në 18 dhjetor 2020 është miratuar ligji 126/2020 "Për Metrologjinë", i cili kërkon kryerjen e ndryshimeve/përshtatjeve/miratimeve/saktësimeve si të kuadrit rregullator të zbatueshëm, ashtu dhe të kontratës së Konkencionit.

Shoqëria ka të punësuar 28 punonjës në dhjetor 2021 (2020: 26 punonjës).

Administratori i Shoqërisë është z. Hazbi Metaj.

Adresa e Shoqërisë është Bulevardi Dëshmoret e Kombit, Kullat Binjake, Kati 2, Tiranë, Republika e Shqipërisë.

2. Bazat e përgatitjes

Shoqëria mban regjistrimet kontabël dhe përgatit Pasqyrat Financiare në përputhje me legjislacionin kontabël në Shqipëri. Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

2.1 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar në koston historike. Bazat e matjes për çdo aktiv, detyrim, të ardhur apo shpenzim shpjegohen me detaje në vazhdim të këtij shënimi shpjegues.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të kërkon të përdoren vlerësime të rëndësishme kontabël. Gjithashtu është e nevojshme që drejtimi të përdorë gjykimin e tij në zbatimin e politikave kontabël të shoqërisë. Fushat në të cilat kanë një shkallë të lartë gjykimi dhe kompleksiteti, ose ku supozimet dhe vlerësimet kanë ndikim domethënës në pasqyrat financiare janë të paraqitura në shënimin 4 "Gjykime dhe gjuarje të rëndësishme kontabël".

2. Bazat e përgatitjes (vazhdimi)

2.2 Vijimësia

Në mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli përhapjen e COVID-19 një pandemie globale. Në përgjigje të pandemisë, autoritetet shqiptare zbatuan masa të shumta në përpjekje për të kufizuar përhapjen dhe ndikimin e COVID-19, si ndalimet dhe kufizimet e udhëtimit, karantina dhe kufizimet deri në mbyllje të aktivitetit të bizneseve. Pavarësisht lehtësimeve në disa nga masat e mësipërme, që nga 31 dhjetori 2021, nivelet globale të infeksionit mbeten të larta, shkalla e vaksinimit është relativisht e ulët dhe ekziston rreziku që autoritetet shqiptare të vendosin kufizime shtesë në periudhat e mëvonshme, për shkak të varianteve të reja të shfaqura të virusit.

Në vitin 2021 ekonomia shqiptare tregoi dinamikë pozitive në rimëkëmbjen nga pandemia.

Menaxhimi po ndërmerr masat e nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë e operacioneve dhe për të mbështetur klientët dhe punonjësit e saj.

Efektet e ardhshme të situatës aktuale ekonomike dhe masat e mësipërme janë të vështira për t'u parashikuar dhe pritjet dhe vlerësimet aktuale të menaxhimit mund të ndryshojnë nga rezultatet aktuale.

Drejtimi beson se Shoqëria do vazhdojë të realizojë fitime në të ardhmen dhe nuk do të cënohet parimi i vijimësisë. Ndaj, Shoqëria ka përgatitur këto pasqyra financiare bazuar në parimin e vijimësisë.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat Financiare paraqiten në Lekë, e cila është monedha funksionale e shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Degës dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

3. Politikat kryesore kontabël

Politikat kryesore kontabël të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare janë të prezantuara më poshtë. Këto politika janë përdorur në mënyrë konsistente në të gjitha vitet e prezantuara, përveçse kur specifikohet ndryshe.

3.1 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një aktiviteti afatgjatë material njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundur që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

3.1 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjate material. Amortizimi vjetor i aktiveve është si më poshtë:

Aktive afatgjata materiale	%
Pajisje dhe instalime teknike	20
Aktive të tjera	20
Pajisje informatike	25

Metodat e amortizimit dhe vlerat e mbetura rishikohen në çdo datë raportimi.

Aktivët afatgjata jomateriale

Aktivët afatgjata jomateriale përfshijnë koston e licencave. Këto kosto amortizohen mbi jetën e tyre të dobishme. Amortizimi ngarkohet në masën 15% me metodën lienare.

Marrëveshja koncensionare

Shoqëria njeh një aktiv jomaterial që rrjedh nga një marrëveshje koncesionare, kur ajo ka të drejtë të tarifojë përdorimin e infrastrukturës së koncesionit. Një aktiv jomaterial i marrë si konsideratë për ofrimin e shërbimeve në një marrëveshje koncesionare të shërbimit, matet me vlerën e drejtë në momentin e njohjes fillestare, duke ju referuar vlerës së drejtë të shërbimeve të ofruara. Pas njohjes fillestare, aktivi jo-material matet me kosto, e cila përfshin kostot e kapitalizuara të huamarrjes, duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Jeta e dobishme e vlerësuar e një aktivi jo-material nga marrëveshje koncensionare është më e vogla ndërmjet jetëgjatësisë së aktivit dhe afatit të marrëveshjes koncesionare e cila është periudha nga kur Shoqëria është në gjendje të tarifojë publikun për përdorimin e infrastrukturës deri në fund të periudhës së koncesionit.

3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

3.2 Transaksionet në valutë të huaj

(a) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë. Monedha funksionale e Shoqërisë është Lekë. Përveçse në rastet kur shprehet ndryshe, informacioni financiar është i paraqitur në Lekë.

(b) Transaksionet dhe tepricat në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë përkthyer në Lekë duke përdorur kursin e ditës në datën e transaksionit. Të gjitha humbjet dhe fitimet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e këtyre transaksioneve dhe nga rivlerësimi i zërave monetare në monedhë të huaj me kursin e këmbimit të fundit të vitit njihen në fitim ose humbje.

Zërat jo-monetare nuk përkthehen në fund të periudhës por maten me kosto historike (këmbehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është kryer transaksioni), përveç rasteve kur zërat jo-monetare maten me vlerë të drejtë të cilat këmbehen duke përdorur kurset e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Kurset zyrtare të këmbimit të përdorura për të përkthyer zërat në Pasqyrën e pozicionit financiar të shprehura në monedhë të huaj, janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Euro	120.76	123.70
USD	106.54	100.84

3.3 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset hyrëse bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat vijnë si rezultat i aktivitetit të zakonshëm të shoqërisë. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë e të arkëtueshmeve ose të hyrave nga shitja e të mirave dhe shërbimeve që vijnë nga aktiviteti i zakonshëm i shoqërisë. E ardhura paraqitet neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar ("TVSH"), kthimet, uljet tregtare.

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse. Të ardhurat njihen nëse ka mundësi që të realizohen flukse të ardhshme hyrëse dhe këto flukse mund të maten në mënyrë të besueshme.

3.4 Llogari e kërkesa të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi.

3.5 Inventarët

Inventarët njihen fillimisht me kosto historike dhe në vijim vlerësohen me vlerën më të vogël mes koston dhe vlerës së realizueshme neto. Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes për njësi, i zvogëluar me shpenzimet e ndryshueshme të shitjes. Kostoja e inventarit përfshin koston e të gjitha materialeve të lidhura drejtpërdrejt me prodhimin dhe koston e shndërrimit të këtyre materialeve në produkte përfundimtare. Kur inventarët konsumohen, vlera e tyre e mbetur njihet si shpenzim në periudhën në të cilën e ardhura përkatëse njihet. Shuma e rënies në vlerë të inventarëve deri në vlerën e realizueshme neto si dhe të gjitha humbjet nga inventarët njihen si shpenzime në periudhën në të cilën rënia në vlerë apo humbja ndodh.

3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

3.6 Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar.

3.5 Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë arkën dhe llogaritë rrjedhëse në banka.

3.6 Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e performancës.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e performancës.

(i) Aktivët jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jofinanciare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.7 Detyrimet financiare

Shoqëria i njeh fillimisht detyrimet financiare në datën e tregtimit, kur bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Shoqëria e regjistron një detyrim financiar kur detyrimet e tij kontraktuale shlyhen ose anulohen apo përfundojnë. Aktivët dhe detyrimet financiare paraqiten me vlerë neto në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëriaka një të drejtë ligjore për të netuar shumat e tyre, dhe ka për qëllim ose të shlyejë shumën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Detyrimet financiare të Degës janë si vijon: hua dhe llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera. Këto detyrime financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kosto të lidhura direkt me transaksionin. Për huatë e marra drejtpërdrejt nga Shoqëria Mëmë, norma e tregut është përcaktuar fillimisht duke iu referuar normave mesatare të ofruara nga banka e nivelit të dytë në Shqipëri. Diferenca midis vlerës së drejtë në momentin e njohjes fillestare dhe vlerës nominale të huasë konsiderohet si kontribut nga aksioneri dhe kontabilizohet si rezervë në kapital.

3.8 Përfitimet e punonjësve

Pagat, kontributet ndaj shtetit dhe sigurimet, leja e zakonshme dhe jo, shpërblimet, përfitimet jo monetare (si p.sh shërbimet shëndetësore) janë përllogaritur në vitin kur këto shërbime janë kryer ndaj punonjësve të Degës.

3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e performancës përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogarit mbi diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

3.10 Qiraja

Shpenzimet e qirave, në të cilat një pjesë e madhe e riskut dhe përfitimeve të pronësisë mbarten nga qiramarrësi, klasifikohen si qira financiare. Pagesat e kryera për qiranë financiare (neto nga ndonjë përfitim të marrë nga qiradhënësi) ngarkohen në fitim ose humbje me metodë lineare përgjatë periudhës së qirasë. Faktorët të cilat konsiderohen përfshijnë gjatësinë e afatit të qirasë në lidhje me jetën ekonomike të aktivit, vlerën aktuale e pagesave minimale të qirasë në lidhje me vlerën e drejtë të aktivit, dhe nëse Shoqëria merr pronësinë e aktivit në fund të afatit të qirasë

Të gjitha qiratë e tjera janë trajtuar si qira operative. Kur Shoqëria është një qiramarrësi, pagesat për marrëveshjet e qirasë operative njihen si shpenzim në bazë lineare përgjatë afatit të qirasë.

4. Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të drejta të arkëtueshme analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Llogari të arkëtueshme	14,913,125	16,585,840
Totali	14,913,125	16,585,840

NOA Inspect ka realizuar verifikime fillestare, verifikime jashtë rradhe, verifikime periodike, kontrole dhe sigurime të regjimit automatik dhe audite të instrumenteve matëse ligjorisht të kontrolluar në pikat e tregtimit të karburantit dhe gazit.

5. Të tjera të arkëtueshme

Të tjera të arkëtueshme analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Shpenzime të shtyra	5,805,301	-
Parapagime të dhëna	772,875	-
TVSH e arkëtueshme	-	4,717,531
Të tjera	610,000	324,061
Totali	7,188,176	5,041,592

Shpenzime të shtyra paraqesin shpenzime të bëra për riparimin e ambjenteve me qira dhe për blerje të licencave që do të shpërndahen në periudhat e ardhshme.

Shoqëria Konkensionare NOA Inspect sh.p.k
Shënime Shpjeguese mbi Pasqyrat Financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
(shumat në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

6. Mjetet monetare

Mjetet monetare analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Mjete monetare në bankë	31,557,644	18,273,980
Mjete monetare në arkë	6,041	-
Totali	31,563,685	18,273,980

7. Aktivet afatgjata jomateriale – e drejtë konkensionare

Aktivët afatgjata jomateriale – e drejtë konkensionare përfshijn kostot e blerjes së sistemeve matëse të pistoletave të karburantit dhe GLN si dhe pajisjet ndihmëse për procesin e verifikimit të kostot për dizajnimin dhe zhvillimin e programit kompjuterik, blerjen furgonave të rinj për ekipet e inspektorëve në terren, blerjen e paisjeve kompjuterike etj.

	Aktivët afatgjata jomateriale – e drejtë konkensionare	Totali
Kosto		
Gjendja më 1 janar 2020	71,556,471	71,556,471
Shtesa	8,659,458	8,659,458
Pakesime	-	-
Gjendje 31 dhjetor 2020	80,215,929	80,215,929
Shtesa	14,281,135	14,281,135
Pakësimë	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	94,497,064	94,497,064
Zhvlerësimi i akumuluar		
Gjendja më 1 janar 2020	-	-
Shpenzimi i vitit	(14,633,449)	(14,633,449)
Pakësimë	-	-
Gjendje me 31 dhjetor 2020	(14,633,449)	(14,633,449)
Shpenzimi i vitit	(14,395,229)	(14,395,229)
Pakësimë	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	(29,028,678)	(29,028,678)
Vlera kontabël neto		
Më 31 dhjetor 2020	65,582,480	65,582,480
Më 31 dhjetor 2021	65,468,386	65,468,386

8. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Të pagueshme nga aktiviteti	8,919,264	7,979,095
Totali	8,919,264	7,979,095

9. Hua afatshkurtër nga palët e lidhura

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Hua afatshkurtër nga palët e lidhura	109,297,709	109,297,709
Totali	109,297,709	109,297,709

Hua afatshkurtër nga palët e lidhura paraqesin detyrimin e huasë që Shoqëria ka marrë nga shoqëria NOA Control Shpk.

Shoqëria Konkensionare NOA Inspect sh.p.k
Shënime Shpjeguese mbi Pasqyrat Financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
(shumat në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

10. Detyrime të tjera

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Shpenzime të përlogaritura	6,668,529	-
Të pagueshme ndaj sigurimeve shoqërore/ shëndetsore	781,392	787,444
TVSH e pagueshme	616,017	-
Parapagime të marra	581,040	-
Tatim në burim	472,295	58,325
Tatim mbi të ardhurat personale	362,421	-
Totali	9,481,694	845,769

Detyrime të tjera paraqesin detyrime tatimore të Shoqërisë për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore, detyrimet për tatimin mbi të ardhurat, detyrimin për TVSH-në e pagueshme si dhe detyrimin për tatimin në burim të cilat janë paguar në janar 2022.

Parapagime të marra përfaqësojnë parapagime të marra nga klientët gjatë vitit 2021. Shpenzime të përlogaritura paraqesin shpenzime të përlogaritura për trajnimet e stafit, tarifën e koncesionit dhe për interesin e huasë.

11. Detyrim tatim fitimi

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Tatim fitimi	919,437	-
Totali	919,437	-

12. Kapitali

	Pjesëmarrja %	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
NOA Control Shpk	100%	1,000,000	1,000,000
Totali		1,000,000	1,000,000

Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga një kuotë në vlerën 1,000,000 Lekë, e cila zotërohet 100% nga shoqëria NOA Control Shpk.

13. Të ardhurat nga shërbimet

Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Të ardhurat nga shërbimet	96,210,200	64,365,500
Total	96,210,200	64,365,500

Shoqëria Konkensionare NOA Inspect sh.p.k
Shënime Shpjeguese mbi Pasqyrat Financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
(shumat në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

14. Shpenzime administrative

Shpenzime administrative analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Shërbime konsulence	8,802,561	1,555,985
Qira	4,915,109	1,763,232
Shpenzimi transporti	3,222,473	3,658,328
Mirëmbajtje dhe riparime të tjera	4,769,358	14,757
Shpenzime materiale të konsumushme	2,236,980	425,023
Shpenzime mirëmbajtje për makina	2,168,932	1,586,038
Shpenzime postare e telekomunikacion	1,659,768	573,269
Tarifë konkensionare	4,014,393	-
Transferime, udhëtime, dieta	1,429,618	1,012,198
Shpenzime kancelarie	1,368,069	870,599
Sigurime	887,792	1,459,284
Shpenzime certifikimi	695,630	814,910
Honorare	404,184	-
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	350,658	191,680
Veshje pune	340,000	1,254,280
Shërbime AtaCarnet	255,339	270,650
Shërbime bankare	178,288	133,728
Shpërblime	-	460,000
Shpenzime të tjera	6,683,481	2,111,023
Total	44,382,633	18,154,984

15. Shpenzime të personelit

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Paga dhe shpërblime	27,325,089	29,558,123
Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore	4,123,494	4,155,144
Totali	31,448,583	33,713,267

16. Shpenzime financiare, neto

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Të ardhura nga interesi	1,173	128
Fitim nga këmbimet valutore	122,943	2,467,892
Të ardhura të tjera financiare	303,803	-
Shpenzime interesi	(2,185,304)	-
Humbje nga këmbimet dhe përkthimet valutore	(112,985)	(52,877)
Totali	(1,870,370)	2,415,143

17. Tatim mbi fitimin

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Fitimi para tatimit	4,113,386	278,942
Shpenzime të panjohura	13,324,880	1,564,587
Humbje fiskale të përdorura	(11,042,022)	(1,843,529)
Fitimi/(humbja) i tatueshëm për periudhën	6,396,244	-
Përqindja e tatim fitimit	15%	15%
Tatim fitimi	959,437	-
Fitimi neto	3,153,949	278,942

Shoqëria Konkensionare NOA Inspect sh.p.k
 Shënime Shpjeguese mbi Pasqyrat Financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
 (shumat në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)
 Amortizimi i humbjeve fiskale

Viti	Humbja fiskale
Humbje fiskale viti 2019	(12,885,552)
Humbje fiskale e përdorur në vitin 2020	1,843,530
Humbje fiskale e përdorur në vitin 2021	11,042,022
Total	-

18. Transaksione me palët e lidhura

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Të pagueshme ndaj palëve e lidhura	Të arkëtueshme ndaj palëve e lidhura
Palët e lidhura	114,060,680	-
Totali	114,060,680	-

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Shpenzime nga palët e lidhura	Të ardhura nga palët e lidhura
Palët e lidhura	11,442,901	-
Totali	11,442,901	-

19. Angazhime dhe kushtëzime

Çështje ligjore

Gjatë aktivitetit të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në dëme dhe çështje ligjore. Në gjykimin e drejtimit, Shoqëria nuk do të ketë ngjarje me peshë të konsiderueshme për të ndikuar në pozicionin financiar të saj ose për të ndryshuar vlerën neto të aktiveve, përveç atyre për të cilat është njohur një provizion në pasqyrat financiare.

Detyrime të kushtëzuara

Shoqëria nuk ka detyrime të kushtëzuara të rëndësishme të kontraktuara deri në datën e pasqyrës së pozicionit financiar të cilat nuk janë njohur në pasqyrat financiare.

20. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje mbas datës së raportimit të cilat mund të kërkojnë rregullime apo paraqitje të informacionit në pasqyrat financiare të Shoqërisë.